

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 20.06.2024*

**20.06.2024
Ora 12:04**

RENDI I DITËS

Projektvendim: “Për shqyrtimin e kërkesës së komitetit përfaqësues të nismës ligjvënëse të zgjedhësve, për regjistrimin e nismës ligjvënëse të zgjedhësve “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”.

PJESËMARRJA :

KQZ:

- Z. Ilirjan Celibashi, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

- Staf i KQZ: Znj. M. Koja, znj. P. Doçaj.

Parti Politike: S’ka prezent!

**Të tjerë: KRIIK,
 “Shqipëria Bëhet”: E. Çepani, D. Prethi, E. Çela,
 A. Thome, E. Haklaj.**

Z. I. Celibashi: Mirëdita! Atëherë në seancën e sotme publike kemi në rend dite këto çështje:

Projektvendim për shqyrtim e kërkesën e komitetit përfaqësues e nismës ligjvënëse të zgjedhësve për regjistrimin e kësaj nisme për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10019 datë 29.12.2008, Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë. Pastaj, Projektvendim “Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin vetdeklarues zotin Ylli Xhafa, anëtar i Këshillit të Bashkisë Bulqizë, propozuar nga Partia Demokratike e Shqipërisë, për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”.

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 20.06.2024*

Projektvendim “Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin vetdeklarues zotën Marcelio Mara kandidat për anëtar për Këshillin e Bashkisë Kuçovë, propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Aleanca Progresiste (LZHK), për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”.

Projektvendim për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin vetdeklarues zotën Mark Nikaj kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Lezhë, propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Socialdemokrate, po për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”.

Projektvendim “Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin vetdeklarues zotën Boris Asllan Shakaj, kandidat për deputet i Qarkut të Tiranës, propozuar nga subjekti zgjedhor, “Nisma Thurje”, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021”.

Projektvendim për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Fier, në Këshillin e Bashkisë Libohovë dhe në Këshillin e Bashkisë Kuçovë.

Mirë, fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës që ka të bëjë me shqyrtimin e kërkesës për regjistrimin e nismës ligjvënëse të disa zgjedhësve për disa shtesa dhe ndryshime në Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.

Znj. M. Koja: Atëherë, Organizata “Shqipëria Bëhet”, me komitet përfaqësues të përbërë nga zoti Adriatik Lapaj, Edlira Çepani, Florian Binaj, Renaldo Saliari dhe Ergys Llanaj kanë paraqitur para Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për t’u pajisur me fletën tip për nismën ligjvënëse të zgjedhësve në Republikën e Shqipërisë, për propozimin e projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në Kodin Zgjedhor”. Në vijim të kërkesës, Komisioneri ka miratuar fletën tip për mbledhjen e nëshkrimeve. Në vijim të kësaj procedure Komiteti Përfaqësues ka depozituar

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 20.06.2024*

kërkesën në datë 6 mars 2024 dhe nënshkrimet për nismën ligjvënëse për propozimin e këtij projektligji. Administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ka bërë verifikimin e 5% të numrit të nënshkrimeve si dhe saktësinë e të dhënave të dokumenteve identifikuese të mbështetësve të nismës. Janë depozituar në total njëzet e një mijë nënshkrime, të nënshkruar nga këta njëzet e një mijë zgjedhës. Ligji kërkon që nisma ligjvënëse të nënshkruhet nga jo më pak se njëzet mijë zgjedhës dhe rezulton që numri i zgjedhësve që kanë mbështetur nismën, plotëson kriteret ligjore të përcaktuara në ligj. Përsa në lart propozojmë miratimin dhe regjistrimin e nismës ligjvënëse të zgjedhësve “Për disa shtesa dhe ndryshime në Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë”. Faleminderit!


Z. I. Celibashi: Faleminderit! Nga përfaqësuesit e nismës, prezent?

Znj. M. Koja: Po, janë përfaqësuesit te nismës.

Z. I. Celibashi: Do të donit të thonit diçka në lidhje me..? Nëse doni, nëse nuk doni nuk ka problem!

Znj. E. Çepani: Përshëndetje! Edlira Çepani, nga Organizata “Shqipëria Bëhet”. Ju falenderojmë që na keni asisituuar në këtë proces, të mbledhjes të paktën të njëzet mijë firmave, njëzet e një mijë firmave të depozituara në Kuvend. Një projektligj për sa i përket ndryshimeve në Kodin Zgjedhor, për sa i përket garantimit të votës së diasporës dhe hapjes së listave zgjedhore dhe rishikimit të sistemit zgjedhor. Dua të falenderoj edhe një herë të njëzet e një mijë zgjedhësit, të cilët kanë shprehur vullnetin e tyre për këtë nismë ligjore dhe uroj të gjitha institucionet ta marrin seriozisht dhe ta bëjnë këtë proces me shpejtësinë e nevojshme për ta garantuar ashtu

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 20.06.2024*

siç Gjykata Kushtetuese ka sanksionuar, brenda zgjedhjeve të vitit 2025, por edhe seriozitetin që me fuqinë e zërit të njëzet e një mijë zgjedhëseve që kanë firmosur këtë iniciativë ligjore. Faleminderit për mbështjetjen dhe jemi në dispozicion për çfarëdolloj gjëje që mund të duhet nga ana jonë!

Z. I. Celibashi: Ju faleminderit! Meqenëse kërkesa dhe e gjithë praktika vijuese vjen në përputhje me të gjitha parashikimet e ligjit nr. 54/2019, për nismën ligjvënëse të zgjedhësve në Republikën e Shqipërisë, vendos:

- regjistrimin e nismës ligjvënëse të zgjedhësve “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.10019 të 29.12.2008, Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
- Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga dita e shpalljes.

Mirë faleminderit!

Vendimi nr. 62

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 20.06.2024*

**20.06.2024
Ora 12:10**

RENDI I DITËS

Projektvendim: “Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm, për subjektin vetëdeklarues zotin Ylli Rushit Xhafa, anëtar në Këshillin e Bashkisë Bulqizë, i propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Demokratike e Shqipërisë” për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”.

PJESËMARRJA :

KQZ:

- Z. Ilirjan Celibashi, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

- Stafi KQZ: Znj. M. Koja, znj. P. Doçaj.


Parti Politike: S’ka prezent!

Të tjerë: KRIIK

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës.

Znj. P. Doçaj: Faleminderit! Pika e dytë e rendit të ditës ka të bëjë me shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm, për subjektin vetëdeklarues zotin Ylli Xhafa. Ylli Xhafa ka kandiduar për anëtar në Këshillin Bashkiak të Bashkisë Bulqizë dhe është propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Demokratike e Shqipërisë dhe në datën 2.04.2023 ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve formularin e vetëdeklarimit. KQZ ka kryer verifikime pranë zyrës së gjendjes civile dhe asaj gjyqësore, nga ku ka rezultuar se kandidati nuk ka ndryshime në përbërësit e gjendjes civile dhe nuk rezulton të jetë i dënuar, por rezulton të jetë i

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 20.06.2024*

rehabilituar. Pasi është konstatuar nga verifikimi i formularit të dekriminalizimit që nuk është në kushtet e ndalimit, janë kryer disa verifikime të mëtejshme të të dhënave në këtë formular nga ku ka rezultuar që, në pyetjen e parë subjekti vetdeklarues, “A jeni dënuar ndonjëherë me vendim gjyqësor të formës së prerë nga ndonjë autoritet shqiptar apo i huaj”, është përgjigjuar me “po” që është dënuar në shtetin grek. Nisur sa më sipër, në kushtet kur organi kompetent për verifikime të mëtejshme është Prokuroria e Përgjithshme, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka vendosur që t’ia kalojë për verifikim më të thelluar Prokurorisë së Përgjithshme. Prokuroria e Përgjithshme ka dërguar verifikimin e rezultatit të verifikimit për subjektin zgjedhor zotin Ylli Xhafa, nga ku u konstatua se nuk ka ndryshime në gjeneralitet, por ka përdorur emra të ndryshëm në shtetin grek, por jo zyrtarisht të regjistruar. Rezulton të jetë dënuar me vendim penal të formës së prerë nga shteti grek për veprën penale vjedhje dhe kalim në mënyrë të paligjshme të kufirit shtetëror. Po nga shteti grek është dënuar për veprën penale “për posedim dhe përdorim të pasaportës së falsifikuar”. Nuk rezulton të jetë i dënuar me ndonjë vendim gjyqësor jo përfundimtar dhe nuk ka masa sigurimi personal ndaj subjektit vetëdeklarues. Në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit dhe rezultatit të verifikimit të Prokurorisë së Përgjithshme konstatojmë se zoti Ylli Xhafa nuk përfshihet në fushën e ndalimit të nenit 2, të ligjit 138/2015 dhe anëtari nuk është në kushtet e moskandidimit apo moszgjedhshmërisë në këtë rast. Bashkëlidhur kemi edhe projektvendim përkatës.

Z. I. Celibashi: Dakord! Konstatojmë që:

- Zoti Ylli Rushit Xhafa, anëtar i Këshillit Bashkiak në Bashkinë Bulqizë, propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Demokratike e Shqipërisë, nuk përfshihet në kushtet e ndalimit për të ushtruar funksionin publik të anëtarit të këshillit.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 20.06.2024*

- Vazhdimin e mandatit të zotit Ylli Rushit Xhafa si anëtar i Këshillit Bashkiak në Bashkinë Bulqizë.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
- Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 30 ditëve nga dita e shpalljes së këtij vendimi.

Vendimi nr. 58

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



RENDI I DITËS

Projektvendim: “Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm, për subjektin vetëdeklarues z. Marceljo Sami Marra, kandidat i propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Aleanca Progresiste LZHK”, për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.

PJESËMARRJA :

KQZ:

- Z. Ilirjan Celibashi, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

- Staf i KQZ: Znj. M. Koja, znj. P. Doçaj.


Parti Politike: S’ka prezent!

Të tjerë: KRIIK

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës.

Znj. P. Doçaj: Përsa i përket kërkesës së tretë të rendit të ditës kemi shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin vetëdeklarues zotin Marceljo Sali Mara, i cili ka kandiduar si anëtar për Këshillin e Bashkisë Kuçovë për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore, të datës 14 Maj 2023. Ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve formularin e dekriminalizimit. Më pas KQZ ka kryer verifikime pranë zyrës së gjendjes civile dhe asaj gjyqësore dhe rezultoi se kandidati nuk ka dënime penale të formës së prere dhe nuk ka ndryshime në gjeneralitete. Më pas Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kryer verifikimin e të dhënave të vetëdeklaruar nga subjekti vetëdeklarues dhe ka

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 20.06.2024*

konstatuar që në pyetjen e shtatë të formularit të vetëdeklarizimit “A është marrë ndonjë masë dëbimi nga ndonjë shtet i huaj?”, subjekti vetëdeklarues është përgjigjur me “po”. Ka një masë dëbimi nga shteti italian dhe përkatësisht nga qyteti Siçilisë. Nisur nga këto konstatime, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve e ka përcjellë rastin për verifikim të thelluar në Prokurorinë e Përgjithshme. Prokuroria e Përgjithshme e ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve miratimin e rezultatit të verifikimit për subjektin zotin Marceljo Mara dhe nga ku konstatohen se: nuk rezulton të jetë i dënuar për ndonjë vepër penale, as me vendim të formës së prerë dhe as me vendim përfundimtar. Po kështu nuk rezulton të ketë qenë i arrestuar apo i ndaluar. Në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit dhe rezultatit të verifikimit zoti Marceljo Mara është kandidat i listës shumëmemërore të propozuar nga subjekti zgjedhor Aleanca Progresiste, por nuk e ka marrë këtë mandat dhe subjekti propozues Aleanca Progresiste LZHK, nuk ka asnjë mandat në Këshillin e Bashkisë Kuçovë. Vlerësohet se ka humbur objekti dhe qëllimi i procedurës administrative të iniciuar përpara datës së zgjedhjeve. Bashkëlidhur keni edhe projektvendimin përkatës.

Z. I. Celibashi: Mirë në këto rrethana,

- Deklarojmë procedurën administrative të përfunduar dhe pa vendim përfundimtar për subjektin vetëdeklarues zotin Marceljo Sali Mara.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
- Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 30 ditëve nga dita e shpalljes së këtij vendimi.

Vendimi nr. 60

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 20.06.2024*

**20.06.2024
Ora 12:15**

RENDI I DITËS

Projektvendim: “Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm, për subjektin vetëdeklarues z. Mark Pal Nika, kandidat i propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialdemokrate”, për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.

PJESËMARRJA :

KQZ:

- Z. Ilirjan Celibashi, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

- Staf i KQZ: Znj. M. Koja, znj. P. Doçaj.

Parti Politike: S’ka prezent!

Të tjerë: KRIIK

Z. I. Celibashi: Po vazhdojmë më tej!

Znj. P. Doçaj: Po pika e katër ka të bëjë me shqyrtim për rezultatin e verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin vetëdeklarues zotin Mark Nika, kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Lezhë. Ka kandiduar për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023 dhe ka depozituar formularët e dekriminalizimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion pranë zyrës së gjendjes civile dhe asaj gjyqësore. Ka rezultuar se Mark Nika është i rehabilituar nuk ka ndryshime në gjeneralitete. Më pas është kryer verifikimi i të dhënave në formularin e dekriminalizimit nga ku është kontaktuar se në pyetjen 1, subjekti vetëdeklarues ka deklaruar se, “është dënues

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 20.06.2024*

në gjykatën e Lezhës me detyrim paraqitje për përdorim pa patentë të automjetit” dhe është i dënuar, ose i arrestuar dhe i ndaluar në shtetin e Zvicrës, për mungesë dokumentacioni. Nisur nga këto rrethana Komisionit Qendror të Zgjedhjeve e ka kaluar rastin për verifikim të thelluar në Prokurorinë e Përgjithshme. Kjo e fundit ka dërguar vendimin për miratimin e këtij rezultati nga ku konstatohet se nuk rezulton të ketë ndryshime në gjeneralitete. Nuk rezulton të jetë i dënuar nga ndonjë vend i huaj, por rezulton që të jetë i ndjekur penalisht nga Prokuroria e Kantelit në Zvicër, për hyrje të paligjshme dhe falsifikim të kartave të identitetit. Në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit dhe rezultatit të verifikimit, konstatohet se subjekti vetëdeklarues zoti Mark Nika, kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Lezhë propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Socialdemokrate, nuk është në kushtet e ndalimit. Rezulton që nuk e ka marrë këtë mandat, por subjekti zgjedhor Partia Socialdemokrate ka fituar shtatë mandate në këtë bashki dhe mund të jetë potencialisht kandidat në të ardhmen. Bashkëlidhur dhe projektvendimi përkatës.

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Atëherë, konstatojmë se zoti Mark Pal Nika, kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Lezhë, propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Socialdemokrate, edhe pasi u vlerësuan rezultatet e verifikimit të thelluar të organit të Prokurorisë së Përgjithshme,

- Nuk përfshihet në kushtet e ndalimit për të ushtruar funksionet publike të anëtarit të këshillit bashkiak.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
- Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 30 ditëve nga dita e shpalljes së këtij vendimi. **Vendimi nr. 59**

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



RENDI I DITËS

Projektvendim: “Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm, për subjektin vetëdeklarues z. Boris Asllan Shakaj, kandidat për deputet, qarku Tiranë, i propozuar nga subjekti zgjedhor “Nisma Thurje” për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021”.

PJESËMARRJA :

KQZ:

- Z. Ilirjan Celibashi, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

- Stafi KQZ: Znj. M. Koja, znj. P. Doçaj.

Parti Politike: S’ka prezent!

Të tjerë: KRIIK

Z. I. Celibashi: Po vazhdojmë më tej!

Znj. P. Doçaj: Po pika e pestë ka të bëjë me shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm, për subjektin vetëdeklarues zotin Boris Asllan Shakaj. Boris Shakaj ka qenë kandidat për deputet në Qarkun e Tiranës, propozuar nga subjekti zgjedhor “Nisma Thurje”, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021. Ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve formularin e dekriminalizimit dhe më pas nga ana e KQZ-së është bërë verifikimi pranë zyrës së gjendjes gjyqësore dhe zyrës së gjendjes civile. Nga ku rezulton që nuk është i dënuar me vendim të formës së prerë dhe nuk rezulton që të ketë ndryshime në përbërësit e gjendjes civile. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve më pas, ka kryer

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 20.06.2024*

verifikimet në të dhënat e formularit të vetëdeklarimit të subjektit dhe ka konstatuar që në pyetjen e shtatë “A është marrë ndonjë masë dëbimi nga ndonjë shtet i huaj?”, subjekti vetëdeklarues ka deklaruar “po”. Është dëbuar nga shteti Gjerman për arsye të refuzimit të azilit. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i ndodhur në këto kushte e ka kaluar rastin për verifikim të thelluar Prokurorisë së Përgjithshme e cila ka miratuar rezultatin e verifikimit të këtij subjekti, nga ku konstatohet se Boris Shakaj nuk rezulton të ketë kryer ndryshime në gjeneralitete. Nuk rezulton të jetë i dënuar me vendim të formës së prerë dhe as me vendim jo përfundimtar dhe nuk rezulton të jetë në hetim nga ndonjë shtet apo nga ndonjë autoritet i huaj. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit dhe rezultatit të verifikimit të thelluar të Prokurorisë, ka konstatuar se zoti Boris Shakaj, kandidat për deputet në Tiranë i Qarkut të Tiranës, nuk e ka marrë mandatin e deputetit dhe as subjekti propozues “Nisma Thurje” nuk ka fituar asnjë mandat në Qarkun e Tiranës. Ndodhur në këto kushte vlerësohet sa ka humbur objekti dhe qëllimi i procedurës administrative e inicuar në fillim të zgjedhjeve! Bashkëlidhur projektvendimi përkatës.

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Atëhere, bazuar në sa u relatua vendosim:

- Deklarimin e procedurës administrative të përfunduar dhe pa vendim përfundimtar për subjektin vetëdeklarues zotin Boris Asllan Shakaj.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
- Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 30 ditëve nga dita e shpalljes së këtij vendimi.

Vendimi nr. 56

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



RENDI I DITËS

**Projektvendim: “Për plotësimin e vakancave në Këshillin e Bashkisë Fier,
Libohovë, Kuçovë.**

PJESËMARRJA :

KQZ:

- Z. Ilirjan Celibashi, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

- Stafi KQZ: Znj. M. Koja, znj. P. Doçaj.

Parti Politike: S’ka prezent!

Të tjerë: KRIIK

Z. I. Celibashi: Po vazhdojmë me pikën tjetër!

Znj. P. Doçaj: Po, po i relatoj të treja njëherësh Kryetar. Duke qenë se Këshilli i Bashkisë Fier, Libohovë dhe Kuçovë na kanë njoftuar për krijimin e vakancës në këshillat përkatës. Nga ana jonë në referim të nenit 164 është vijuar me kandidatët vijues të listave shumemërore të subjekteve zgjedhore përkatëse. Kanë depozituar formularët e dekriminalizimit të tre kandidatët brenda afatit ligjor. Është kryer verifikimi pranë Drejtorisë së Gjendjes Civile dhe asaj Gjyqësore. Është kthyer përgjigje nga Drejtoria e Gjendjes Civile dhe asaj Gjyqësore dhe ka rezultuar që të tre kandidatën nuk kanë ndryshime në përbërësit e gjendjes civile dhe nuk kanë vendime penale të formës së prerë. Në këto kushte dhe në mbështetje të pikës 2 të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, të dhënat e kandidatëve të cilët i kanë deklaruar

***Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU***



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 20.06.2024*

në formularët e dekriminalizimit nuk përbëjnë kushte për mos zgjedhshmërinë e tyre në funksionin e këshilltarit. Bashkëlidhur të treja projektvendimet!

Z. I. Celibashi: Dakord! Atëherë, vendosim:

- Plotësimin e vakancës për Këshillin e Bashkisë Fier, me kandidatin nga lista shumemërore të subjektit zgjedhor Partia Socialiste të Shqipërisë zonjën Lindita Sopoti.
- Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Libohovë, me kandidatin nga lista shumemërore të subjektit zgjedhor “Bashkë Fitojmë”, zonjën Fatbardha Karavidha.
- Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Kuçovë, me kandidatin nga lista shumemërore të subjektit zgjedhor Koalicioni “Bashkë Fitojmë”, zonjën Blerina Amati.

Çështje të tjera nuk kemi? Mirë faleminderit! Seanca mbyllet. Ditë të mbarë!

Vendimi nr. 55, 61, 63

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

